



Asociacioni i Komunave të Kosovës

R A P O R T

nga

Takimi i Kolegjiut për Financa dhe Buxhet

Prishtinë, 16 nëntor 2011

Për: Ertan Munoglu – Menaxher i Programit i AKK-së

Nga: Fisnik Dashi – Koordinator i Kolegjumeve të AKK-së

Lënda: Raport nga takimi i Kolegjiut për Financa dhe Buxhet

HYRJE

Asociacioni Komunave të Kosovës (AKK) në bashkëpunim me GIZ organizoi takimin këtij Kolegjiumi me 16 nëntor 2011 (e mërkurë) me fillim nga ora 11:00 në Restorantin 'Villa Gërmia' në Prishtinë.

Takimi kishte për qëllim të diskutohen këto pika:

- Financimi i aktiviteteve rinore
- Kodi i veçantë buxhetor për sektorin e rinisë

Në këtë takim morën pjesë Drejtorët për Buxhet dhe Financa nga Komunitatet e Kosovës. Po ashtu ishin prezent edhe përfaqësuesit nga GiZ - Albion Zeka dhe Donat Zejnullahu, zyrtarë për sektorin e rinisë. Takimi u kryesua nga menaxheri i programit në AKK, z. Ertan Munoglu.

PËRMBLEDHJE

Qëllimi i përbashkët i AKK-së me ndihmën e GIZ-it ishte diskutimi i përbashkët dhe shqyrtimi i mundësive për një financim më të qëndrueshëm të aktiviteteve rinore në komuna si dhe rishikimin e opsioneve për krijimin e një kodi të veçantë buxhetor për sektorin e rinisë.

Me këtë rast AKK bëri një prezantim të shkurtër të financimit të aktiviteteve rinore dhe krahasimin në periudhë kohore për vitin 2009 dhe 2010 si dhe buxhetin e planifikuar nga qeveria për DKRS-të për vitin 2012, ku edhe nga të dhënat paraprake u vërejt se komunitatet kanë mundësi të kufizuar për tu përgjigjur kërkesave për zbatim të plotë të planeve të veprimit lokal për rini, si dhe mundësitë e pakta të financimit të këtyre aktiviteteve qoftë nga subvencionet/të hyrat vetanake apo nga grantet qeveritare.

Si rrjedhojë Kuvendet Komunale deri më tash kanë aprovuar planet e veprimet të cilat kanë obligim të zbatojnë, mirëpo në mungesë të mjeteve buxhetore hasin në probleme serioze. Me këtë rast u njoftua se AKK ka biseduar me MF dhe MAPL për shqyrtimin e mundësisë së krijimit të një kodi të ri buxhetor në mënyrë specifike për sektorin e rinisë. Teknikisht kjo nuk paraqet problem nga ana e MF, mirëpo shtrohet pyetja se sa do të ishin komunitatet të gatshme të mbështesin një nismë të tillë për kod të ri buxhetor për rininë.

Nga diskutimi i drejtorëve u vërejt se kjo nuk është ndonjë kërkesë e re por që është diskutuar edhe më herët, dhe me këtë rast të gjithë shprehën pajtimin dhe angazhimin e tyre për krijimin e një kodi të veçantë buxhetor sa i përket sektorit të rinisë.

Një gjë është e qartë se një iniciativë e tillë do të ishte në të mirë të planifikimit buxhetor komunal dhe një mënyrë e saktë e aplikimit të mjeteve buxhetore, përmes planifikimit të aktiviteteve rinore si dhe projekteve konkrete në zbatim të planeve të veprimit ku një rëndësi specifike do të jetë menaxhimi dhe mbikëqyrja e mjeteve buxhetore.

Sipas praktikave të deritashme të gjitha mjetet e destinuara janë deleguar në DKRS komunale, ku janë menaxhuar nga drejtori përgjegjës, dhe sipas specifikave të interesit të tyre shumica e mjeteve janë

deleguar në fushën e kulturës dhe të sportit. Deri më tash projektet e sektorit të rinisë janë financuar nga subvencionet si mënyrë jo e qëndrueshme në zbatimin e planeve për veprim nga sektori i rinisë.

Si konstatim i përgjithshëm i të gjitha palëve ishte se subvencionet nuk janë një mënyrë e përshtatshme e përkrahjes së aktiviteteve rinore, mirëpo përpjekjet për krijimin e kodit të ri buxhetor kërkon një përkrahje politike deri tek aprovimi i saj. Nëse me përpjekjet e duhura arrihet deri tek lobimi për një vendim të tillë, me këtë rast do të lehtësonte në masë të madhe edhe përcaktimin e fushës së financimit dhe shpenzimeve të këtyre mjeteve buxhetore për sektorin e rinisë.

Duhet gjetur mënyra e saktë në përcaktimin se çfarë aktiviteteve do të kategorizoheshin si aktivitete rinore. Drejtorët kërkuar që të ketë një diskutim të përgjithshëm në nivel qendror dhe lokal ku edhe do të përcaktoheshin në mënyrë të qartë se cilat janë aktivitetet rinore, kulturore apo sportive, në mënyrë që mos ketë asnjë mëdyshje sa i përket financimit apo sferave të këtyre aktiviteteve të veçanta. Mirëpo kjo gjë është e rregulluar me Ligjin për Fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë (2009/03-L-145) dhe rregulloret përcjellëse.

Nga përfaqësues të GIZ-it u paraqiten kërkesat kryesore për sektorin e rinisë të cilat janë të definuar sipas Planit të Veprimit Rinor. Sipas këtij plani kjo kategori do të ketë prioritet sa i përket inkuadrimit dhe pjesëmarrjes në shoqëri.

Strategjia dhe Plani i Veprimit Për Rini është një strategji gjithëpërfshirëse për të rinjtë, ajo ka për synim përmirësimin e situatës së rinisë, duke përfshirë të gjitha institucionet përkatëse qeveritare dhe joqeveritare, organizatat dhe ofruesit e shërbimeve për hulumtimin dhe plotësimin e nevojave të rinisë dhe gjetjen e mekanizmave për pjesëmarrje të saj në proceset e vendimmarrjes në Kosovë. Strategjia nxitë bashkëpunimin ndërmjet organizatave rinore, përkatësisht ndërmjet të gjitha ministrive, veprimtaria e të cilave lidhet me rini, si dhe ndërmjet organizmave qendrore dhe atyre komunale për të fuqizuar politikat dhe programet rinore. Me anë të kësaj strategjie parashihet zhvillimi i kapaciteteve të rinisë, plotësimi i nevojave të rinisë, si dhe gjetja e formave të ndryshme të pjesëmarrjes së rinisë në proceset e vendimmarrjes në Kosovë. Në këtë dokument janë shqyrtuar prioritetet e rinisë, të paraqitura në 6 kategori: 1) pjesëmarrja e rinisë, 2) edukimi (formal dhe joformal), 3) punësimi, 4) shërbimet shëndetësore, 5) siguria, dhe 6) kultura, sporti dhe rekreacioni. Plani i veprimit për rini përshkruan hapat për realizimin e vizionit, zbatimin e strategjive, përcaktimin e akterëve përkatës, organizatave përgjegjëse dhe mjeteve të nevojshme financiare. Por si përfundim del se buxheti shumë i vogël ka qenë pengesë për zbatim të këtyre planeve në fushat specifike për sektorët e rinisë.

Deri më tash është vërejtur se shpenzimet kryesore në menaxhimin e objektit të Qendrës Rinore, pagesa për koordinatoren e qendrës si dhe disa shërbime të tjera plotësuese janë të ulëta dhe ka mungesë mjeteve dhe fondesh për projektet aktuale. GIZ-i me këtë rast është zotuar se do të financojë në mënyrë të drejtpërdrejtë po aq sa do të financojnë edhe vetë komuna në formë stimulimi nëse krijojnë një kod të veçantë buxhetor, mirëpo deri më tash një gjë e tillë nuk ka ndodhur. Tendanca e GIZ-it është fuqizimi i strukturave administrative për sektorin e rinisë, themelimi i këshillave lokal rinor, hartimi i planeve të veprimit rinor lokal të aprovuara nga KK si dhe financimi i tyre sipas planeve të qarta buxhetore në zbatim të PVR-ve.

Në takim u shqyrtuan edhe mundësitë tjera për tërheqjen e donacioneve, si UNIREF-i (sistemi i flet-pagesave që i lëshojnë komunat) apo kodi i Drejtorisë për kulturë, rini dhe sport, mirëpo të gjithë në fund ua pajtuan se këto nuk janë adekuate për të fuqizuar sektorin e rinisë dhe përmirësuar financimin e aktiviteteve rinore. Prandaj, të gjithë drejtorët shprehën edhe një herë mbështetjen e tyre sa i përket iniciativës së krijimit të një nën-kodi apo (nën-programi) të ri buxhetor si dhe përcaktimin e qartë të gjitha aktiviteteve të cilat përcaktojnë fushëveprimin për sektorin rinor. Po ashtu patjetër të ketë edhe një mbikëqyrje më të hollësishme të vetë donatorëve sa i përket financimit dhe implementimit të projekteve specifike për sektorin e rinisë si dhe raportimin për masën e zbatim të atyre planeve.

Kjo iniciativë duhet të fokusohet që të punohet dhe të krijohen kushtet e punës për vitin 2013 duke marrë parasysh se aprovimi i buxhetit për vitin 2012 është çështje ditësh andaj edhe të gjitha përpjekjet duhet të fokusohen në punën e ardhshme të projekt buxhetit në mënyrë që të jemi të përgatitur për kërkesat në procesin e ardhshëm buxhetor. Po ashtu të planifikohet në mënyrë të saktë dhe në formë të qartë buxheti i ardhshëm në formën e programeve dhe nën-programeve nga Ministria e Financave dhe donatorët e ndryshëm për financimin e sektorit të rinisë në të ardhmen.

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

- Drejtorët për Buxhet dhe Financa përkrahin krijimin e (nën)kodit buxhetor për sektorin e rinisë
- Planifikimi dhe zbatimi i (nën)kodit të ri vetëm për buxhetin e vitit 2013
- Donatorët duhet mbikqyrë dhe raportuar në mënyrë më të përpikët për projektet e rinisë